

ANASTAS DODI

DREJTSHKRIMI DHE SHQIPTIMI LETRAR

«Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe (projekt), të vitit 1967 përbëjnë një sukses të shënuar të gjuhësisë sonë. Ato janë jo vetëm kodifikimi më i plotë e më sistematik i drejtshkrimit të gjuhës sonë, por dhe një kontribut i rëndësishëm për kristalizimin përfundimtar të normave të shqipes letrare kombëtare.

Zbatimi i një drejtshkrimi të njësuar tregon se edhe normat themelore të gjuhës sonë letrare tashmë janë njësuar në gjithë nënsistemet e gjuhës dhe janë të përbashkëta për gjithë kombin.

Procesin e njësitimit të normave të gjuhës sonë letrare e ka udhëhequr dhe do ta udhëheqë forma e shkruar e kësaj gjuhe, prandaj përcaktimi i drejtë dhe kodifikimi i normave drejtshkrimore kanë rëndësi të madhe për gjendjen e tanishme dhe rrugët e zhvillimit të gjuhës letrare.

Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe mbështeten në një analizë dhe në një koncept të drejtë gjuhësor për gjendjen e sotme dhe për prirjet e zhvillimit të gjuhës sonë letrare. Kjo është bërë e mundur në sajë të studimeve të kryera pas çlirimit në fushat e dialektologjisë, leksikologjisë, fonetikës, gramatikës dhe të etimologjisë. Komisioni hartues i projektit ka marrë parasysh shkallën e përhapjes dhe të përdorimit të dukurive gjuhësore, tendencën e zhvillimit si dhe kushtëzimin e tyre sistemor, që përbën një nga kriteret më të rëndësishme brendagjuhësore të normësimit.

Parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës sonë është parimi fonetik. Zbatimi i këtij parimi si për variantet letrare dialektore, ashtu dhe për gjuhën letrare është bërë i mundshëm, për shkak të tipareve themelore të sistemit fonematik të shqipes letrare, ku alternimet e gjalla të fonemave kanë një peshë të vogël dhe nuk pengojnë realizimin e njësisë së morfemave në shkrim. Për këtë ka ndihmuar dhe sistemi i përshtatshëm grafik i gjuhës sonë, që mori trajtë përfundimtare me caktimin e alfabetit të sotëm në Kongresin e Manastirit, sistem grafik që me ndonjë përjashtim të vogël na jep mundësi të shprehim me lehtësi dhe përpikmëri anën tingullore të gjuhës sonë.

Parimi fonetik që edhe në të kaluarën ka qenë në bazën e drejtshkrimeve të gjuhës sonë, ka ndikuar që kjo gjuhë të qëndrojë afër gjuhës së popullit. Gjuha jonë letrare s'është shkëputur asnjëherë nga gjuha popullore, jo sepse tek ne mungonte një traditë shkrimi dhe drejtshkrimi. Një traditë e tillë pesëshekullore ekzistonte, qoftë edhe

e kufizuar në funksionet e saj shoqërore. Por themelet e shqipes letrare kombëtare u hodhën në periudhën e Rilindjes. Kjo gjuhë u zhvillua si një kërkesë e kohës: t'i shërbejë idesë së madhe të bashkimit të popullit dhe të ngritjes së tij në luftën për çlirim. Prandaj ajo duhej të ishte gjuha e popullit, që të kuptohej e të përvetësohej prej tij. Këto tradita demokratike të Rilindjes u thelluan dhe u ngritën në një shkallë të re cilësore nga gjuhësia shqiptare pas çlirimit të vendit në 1944 dhe gjejnë shprehjen e tyre më të plotë dhe në Rregullat e drejtshkrimit të vitit 1967.

Duke vështruar drejtshkrimin e gjuhës sonë në prizmin e anës tingullore të gjuhës, mund të themi se në vijat kryesore ai jo vetëm mbështetet në shqiptimin letrar, por edhe ndikon për njësimin e tij të mëtejshëm në ato raste, kur normat e drejtshqiptimit ende nuk janë përgjithësuar. Lidhja dhe marrëdhënia midis drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit është e dyanshme: drejtshkrimi ndjek dhe pasqyron evolucionin e anës tingullore të gjuhës; por njëkohësisht ndihmon për njësimin dhe përgjithësimin e normave të tij, sepse përhapja dhe ngulitja e normave të drejtshqiptimit përgjithësisht mbeten prapa, vonohen në krahasim me drejtshkrimin. Prandaj drejtshkrimi nuk mund të pasqyrojë gjithnjë besnikërisht shqiptimin, qoftë dhe shqiptimin letrar.

Në marrëdhënjen drejtshkrim-drejtshqiptim rëndësi ka problemi a është mbështetur kodifikimi i drejtshkrimit tonë në gjëndjen e sotme të shqiptimit letrar. Dihet se kufijtë kohorë të «së sotmes» nuk janë të njëjtë për gjithë nënsistemet e gjuhës. Ana tingullore e gjuhës pëson evolucion më të shpejtë, prandaj këta kufij janë më të afërt se ata të leksikut dhe të gramatikës, që për gjuhën tonë në vija të përgjithshme nisin që nga Rilindja. Mbështetja në traditën e së kaluarës si dhe synimi për qëndrueshmërinë e paraqitjes së trajtave gjuhësore sjellin si pasojë që drejtshkrimi në disa raste të mos pasqyrojë zhvillimin e gjuhës së folur letrare. Nga kjo pikëpamje, mendoj se drejtshkrimi ynë për anën tingullore në shumicën e rasteve e ka kapërcyer këtë kontradiktë të brendshme, që përmban vetë kodifikimi.

Natyrisht në hallka të veçanta të zgjidhjeve ka vend për vërejtje dhe diskutime, sidomos për ë-në e patheksuar në trup të fjalës, për të cilën dhe ne do të shprehim këtu disa mendime.

Njohja e sistemit fonetik të gjuhës letrare dhe e ligjeve të zhvillimit të tij ka rëndësi të veçantë për të gjykuar në se normat e drejtshkrimit e pasqyrojnë drejt anën tingullore të gjuhës.

Sistemi fonetik i shqipes letrare të përbashkët nuk përputhet plotësisht me asnjë nga sistemet fonetike të dialekteve, as të dy varianteve të gjuhës së shkruar. Baza e këtij nënsistemi janë elementet e përbashkëta të të gjithë shqipes. Bashkëveprimi ndër-dialektor që karakterizon rrugën e formimit të gjuhës sonë letrare si dhe konvergjenca e dy varianteve të gjuhës së shkruar sollën ndryshime dhe në sistemin fonetik të shqipes letrare kombëtare. Kjo gjuhë është pasuruar me fjalë dhe me elemente gramatikore e fjalëformuese prej të dy dialekteve. Këto kanë sjellë me vete dhe tipare fonetike, që janë integruar në gjuhën letrare, sepse ana tingullore e gjuhës ek-

ziston vetëm nëpërmjet të fjalëve dhe formave gramatikore. Kjo natyrisht nuk do të thotë se në strukturën fonetike të gjuhës letrare janë grumbulluar elemente heterogjene. Në këtë strukturë janë integruar tipare të tilla, që janë në pajtim me sistemin e që lejohen prej tij.

Pamja e përgjithshme e sistemit fonetik të gjuhës letrare përcaktohet nga tiparet fonetike të koinesë letrare jugore si p.sh. ë-ja e theksuar, përdorimi më i dendur i ë-së së patheksuar, mungesa e hundorësisë së zanoreve, rotacizmi në një numër fjalësh të vjetra të shqipes dhe në disa formante gramatikore, mosasimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *nd, mb, ng* etj. Megjithatë në drejtshkrimin e gjuhës letrare janë lënë mënjanë një sërë tiparesh fonetike tipike për variantin jugor të gjuhës së shkruar, siç janë p.sh. shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme fundore dhe në trup të fjalës përpara bashkëtingëlloreve të shurdhëta, errësimi i e-së përpara bashkëtingëlloreve hundore në fjalë të tipit *vend, mend, dhen* etj.

Me integrimin e disa tipareve fonetike veriore, siç janë p.sh. togu i zanoreve *ue* në fjalë të tipit *i punueshëm, i qëndrueshëm*, mungesa e rotacizmit në një numër fjalësh që vijnë nga gegërishtja si *krenar, rini* etj., baza mbështetëse jugore e gjuhës letrare për sistemin tingu-llor është zgjeruar.

Një nga meritat kryesore të komisionit hartues të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes» është fakti se ai edhe për sistemin fonetik është udhëhequr gjithnjë nga parimi i ngritjes në normë të dukurive të përbashkëta të gjuhës shqipe, edhe në raste kur këto dukuri për koinesë jugore nuk kanë qenë shumë të përhapura. Ky qëndrim me rëndësi parimore është mbështetur në kritere të drejta shkencore dhe nuk ka krijuar amalgama gjuhësore, që s'kanë jetë të gjatë. Janë shfrytëzuar mundësitë që jep sistemi fonetik i shqipes letrare, modelat e strukturës së saj. Në të njëjtën kohë janë mënjanuar ato tipare, që s'përputhen me këtë strukturë, si p.sh. hundorësia, asimilimet e grupeve të bashkëtingëlloreve dhe monoftongizimi i disa grupe zanorësh.

Mendoj se trajtimi i këtij problemi ka rëndësi parimore, sepse në të kaluarën (edhe pas çlirimit) ka pasur mendime që zgjerimi i bazës dialektore mbi të cilën ngrihet gjuha letrare, me tipare fonetike të dialekteve të tjera është i gabuar e artificial dhe si i tillë s'mund të ketë jetë të gjatë.

Marrëdhënja e drejtshkrimit me shqiptimin letrar ka të bëjë me shumicën e rregullave të kodifikuara në drejtshkrimin tonë. Por në caqet e kësaj kumtese ne do të ndalemi vetëm tek ë-ja e patheksuar, trajtimi i së cilës përbën një nga dallimet kryesore të formës së shkruar nga forma e folur e gjuhës letrare.

Shqipja letrare kombëtare për drejtshkrimin e ë-së së patheksuar në vija të përgjithshme është mbështetur në shqiptimin e koinesë jugore, që ruan më mirë edhe traditën e shkrimit të të dy dialekteve. Por drejtshkrimi edhe këtu nuk paraqitet si një pasqyrim besnik i shqiptimit as për koinesë jugore, përveç të tjerash, sepse ai mbështetet jo vetëm në parimin fonetik, por edhe në parimin morfologjik e historik.

Siç tregon historia e gjuhës shqipe, në këta tre-katër shekujt e fundit ë-ja e patheksuar në mjaft pozicione ka filluar të bjerë. Dialekti verior në këtë drejtim është treguar më inovues dhe është larguar më tepër nga ajo gjendje e gjuhës së shekujve XVI-XVII, kur të dy dialektet tona në këtë pikë ishin mjaft afër njëri-tjetrit. Por dhe dialekti jugor, megjithëse më me ngadalë, ka ecur dhe po ecën po në këtë rrugë. Ky evolucion është pasqyruar hap pas hapi edhe në traditën tonë letrare të së kaluarës si edhe në shqipen letrare kombëtare, sidomos në formën e folur të saj. Kjo gjendje e shqiptimit letrar pasqyron jo vetëm evolucionin e koinësë jugore, por është dhe rezultat i bashkëveprimit me shqiptimin verior.

Drejtshkrimi duke synuar që të ruajë një farë stabiliteti relativ të gjuhës së shkruar dhe të atyre treguesve semantiko-morfologjikë të saj, që lidhen me ruajtjen e ë-së, sidomos në pozicion fundor, me të drejtë nuk e ka pasqyruar në shkallë të plotë evolucionin e këtij tingulli.

Në shqiptimin letrar ë-ja e patheksuar në fund të fjalës është reduktuar shumë dhe ka përfunduar në një tingullth të shkurtër, që pasqyron një zanore të shurdhët, e cila u jep një ngjyrim karakteristik më ë bashkëtingëlloreve fundore. Në pozicione të caktuara, sidomos përpara një zanoreje të fjalës ndjekëse, ky tingullth mungon krejt, bile dhe në shqiptimin e ligjërimit libror e në të folur të ngadalshëm, që karakterizohen nga një artikullim i qartë dhe i shkoqur (por ruhet në shqiptimin letrar ë-ja në fjalët proklitike në, më, të, që).

Drejtshkrimi e ruan ë-në fundore si tregues të numrit shumë (punëtor-ë, fshatar-ë, fishek-ë), të gjinisë (vajz-ë, pun-ë), dhe si format fjalëformues (pres-presë, plak-plakë, etj.).

— Kur është dy rrokje larg theksit, ë-ja e patheksuar në shqipen e sotme nuk shqiptohet. Ky ligj fonetik pjesërisht pasqyrohet dhe në rregullat e drejtshkrimit, megjithëse kjo ka sjellë si pasojë që në këto raste të mos ruhet njësia e trajtave të mbaresave dhe të prapashitesave morfologjike (krahaso i zjarhtë — i hekurt, dorë — kumbull, vezë — dhëmbëz, vajzë — vajzës por kumbull — kumbullës, lamë — shkuan, lanë — shkruan). Por në raste të tjera, p.sh. në sistemin foljor ky ligj fonetik nuk është zbatuar, aty ruhet njësia e trajtave edhe dy rrokje larg theksit p.sh. bëjmë-lyejmë, të lexojë — të lyejë, Në këto çështje drejtshkrimi nuk ka ndjekur një vijë konsekuente. Mendoj se për këto raste duhet të zbatohet me konsekuencë ligji fonetik i rënies së ë-së fundore.

Nuk na duket me vend gjithashtu që trajtat e mënyrës urdhërore njëjës të foljeve *flas*, *hyj*, *bie*, *shpie*, *shtie*, *zë*, *përzë* të shkruhen me ë fundore (folë, hyrë, përzërë etj.), jo vetëm se këto në shqiptimin letrar dalin pa ë, por edhe sepse kjo ë nuk del as në numrin shumë në trajta si *folni*, të cilën, për të ndjekur rregullën duhet ta shkruanim *folëni*. Kjo ë fundore sot nuk kryen ndonjë funksion morfologjik, rënia e saj nuk thyen strukturën e trajtave, sepse ajo paraqitet në një varg të mbyllur. Veç kësaj në disa raste krijohen edhe homoforme, p.sh. tek foljet *hyj*, dhe *vë* (hyrë, — urdhërore dhe pjesore, vërë — folje dhe emër).

Përsa i përket anës metodike të parashtrimit të çështjeve, rregullat e drejtshkrimit që lidhen me ë-në fundore, mendoj se duhet të sistemohen dhe të përgjithësohen më shumë.

— Ë-ja e patheksuar që ndodhet në fund të temës në fjalët e përbëra dhe në fund të rrënjës në fjalët e prejardhura, kur ndodhet në rrokje të hapur në shqiptimin letrar përgjithësisht trajtohet si ë-ja në fund të fjalës. Drejtshkrimi në këto raste synon të ndjekë parimin morfologjik, i cili zbatohet në mënyrë konsekuente në fjalët e përbëra (ditëlindje, bukëpjekës, pesëvjeçar etj.), kurse në fjalët e prejardhura në mjaft raste thyhet, duke ndjekur kështu shqiptimin letrar (anëtar, punëtor, por zyrtar, besnik, i frikshëm, i përgjithshëm etj.). Në fjalët e përngjitura zakonisht ndiqet shqiptimi: gjithë-gjithnjë, gjithmonë etj. Nuk po ndalemi hollësisht në këto çështje që kërkojnë një trajtim të gjerë.

— Drejtshkrimi i ë-së së patheksuar në trup të fjalës përbën një nga nyjet më të vështira për formën e shkruar të gjuhës sonë letrare.

Në këtë pozicion ë-ja nuk luan rolin e treguesit morfologjik, nuk lidhet me anën semantike të gjuhës, prandaj drejtshkrimi i saj është vendosur duke u mbështetur në kritere të tjera, nga të cilat, për mendimin tonë, kryesorët do të ishin: gjendja e sotme e shqiptimit letrar, tradita e gjuhës së shkruar dhe lehtësia ose vështirësia që paraqesin grupet e bashkëtingëlloreve, që do të krijoheshin me rënien e ë-së.

Përsa i takon shqiptimit letrar, mund të thuhet se, duke përjashtuar rrokjen e hapur nistore, në rrokjet e tjera të hapura, kjo zanore pothuaj nuk shqiptohet nga asnjë nga stilet e shqiptimit ashtu si dhe ë-ja fundore në rrokje të hapur.

Në rrokjen e parë, edhe kur ajo është e hapur, ë-ja shqiptohet gjithnjë, kështu që drejtshkrimi pasqyron shqiptimin letrar, p.sh., dëshirë, dëgjoj, këndoj, mëngjez, shëndet,

— Për fjalët e parme, drejtshkrimi ka pasqyruar rënien e kësaj zanoreje në trup të fjalës në rrokje të hapur jonistore në rastet kur pas ë-së vjen një bashkëtingëllore sonante, me kusht që nga rënia e ë-së të mos krijohen grupe bashkëtingëlloresh të vështira për shqiptim, p.sh. shkruajmë: pupël-pupla, emër-emri, por dhëlpër-dhëlpëra, kulpër-kulpëra, i verbër-i verbëri etj.

Për rregullat e drejtshkrimit që lidhen me këtë çështje, mund të bëheshin këto vërejtje dhe sugjerime:

a) Aty mungon përgjithësimi dhe në mjaft raste vështrimi i çështjeve sipas kriterit fonetik, ashtu si dhe në rregulla të tjera që trajtojnë ë-në e patheksuar. Në rregullat e drejtshkrimit për këtë problem nuk është kapërcyer deri në fund sistemimi i materialit sipas pjesëve të ligjëratës, që ishte karakteristike për «Ortografinë e gjuhës shqipe» të vitit 1956.

b) Ndarja e grupeve të bashkëtingëlloreve në të vështira dhe të lehta për t'u shqiptuar nuk ka marrë parasysh kufinj të ndarjes fonetike të fjalës në rrokje. Këta kufinj luajnë një rol me rëndësi për të gjykuar për lehtësinë ose vështirësinë e shqiptimit të grupeve të bashkëtingëlloreve. Në fjalë të tilla si dhëlpër-dhëlpëra, gjarpër-gjarpëri, kulpër-kulpëra, grupet *lpr*, *rpr*, simbas mendimit tonë, nuk pa-

raquesin vështirësi shqiptimi, jo vetëm se kanë në përbërjen e tyre bashkëtingëllore likuide, por edhe sepse midis tyre kalon kufiri i rrokjes që i ndan ato l/pr, r/pr. Gjatë shqiptimit ë-ja në këto raste bie, gjë që tregon se grupet e krijuara nuk paraqesin vështirësi shqiptimi. Ato ruhen në shqiptimin e disa të folmeve jugore, gjë që këtu s'duhet të peshojë.

Në kapitullin «Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit» (ku janë paraqitur në të njëjtin plan ndarja fonetike me ndarjen morfologjike dhe drejtshkrimore) parimi që grupet e bashkëtingëlloreve të quhen të lehta për t'u shqiptuar, po qe se në gjuhën shqipe ka fjalë që nisin me këto bashkëtingëllore, mendoj se është formuluar ngushtë, nuk i kap të gjitha rastet. P.sh. në modelet e renditjes së bashkëtingëlloreve e zhurmët + sonante, për mendimin tonë, të dy bashkëtingëlloret shkojnë bashkë jo vetëm në fjalë si ve-gla, li-bri, por dhe në fjalë të tipit mi-sri, qi-qra, megjithëse në gjuhën letrare s'ka fjalë që të nisin me këto grupe bashkëtingëlloresh.

c) Zgjidhjet që jepen për shkrimin e ë-së, të vështuara nga pikëpamja e grupeve të bashkëtingëlloreve që do të formoheshin me rënien e saj nuk janë konsekuente. P.sh. në ortograme fjalësh të prejardhura si i frikshmi, i përbotshmi, i turpshmi etj. është vendosur që ë-ja e prapashtesës -shëm dhe ajo e temave të fjalëve më zanore të bjerë, kështu që grupet kshm, tshm, rpsm, dalin si të lehta për t'u shqiptuar.

— Për fjalët e prejardhura në temë në -ër drejtshkrimi ka vendosur që ë-ja të ruhet pas një bashkëtingëlloreje të zëshme (përveç v-së), ose një grupi bashkëtingëlloresh, përveç grupeve nd, st. Pra kemi:

vepër-vepra, veprorë, veprim

emër-emri, por emërorë, emërim

i pastër — i pastri, pastroj, pastrim

i poshtër — i poshtri, por poshtëroj, poshtërim.

Mendoj se karakteri i zëshëm i bashkëtingëllores përpara ë-së nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm për ruajtjen e kësaj zanoreje në rrokje të hapur, sepse ë-ja bie jo vetëm përpara n-së dhe nd-së që përmendin «Rregullat...» por dhe para bashkëtingëlloreve të tjera të zëshme, si p.sh. përpara b-së dhe d-së në fjalë të tilla si libër-libraria, kodër-kodrinor (përndryshe duhej të shkruanim libëria, kodërinor). Në këto raste gjatë shqiptimit ë-ja ndihet krejt e rrëgjuar, megjithëse në pozicion paratheksor ajo ndihet disi më shumë se në pozicionin pastheksor.

Do të ishte e dobishme që për këto raste drejtshkrimi ta shihte zgjidhjen në sistem. Forma e folur e gjuhës letrare jep një mbështetje të sigurt për këtë. Pra, sipas modelit i pastër i pastri, pastroj, pastrim të bënte dhe i poshtër — i poshtri, poshtroj, poshtrim. Atje ku ë-ja bie në trajtën e shquar të synohet që të mos shkruhet as në fjalët e prejardhura.

Nuk i përgjigjet shqiptimit të sotëm as ruajtja e ë-së në rrokje të hapët në fjalë që mbarojnë me -ës, -ësh, por synimi i drejtshkrimit për të ruajtur strukturën e prapashtesës këtu gjen zbatim kon-

sekuent, prandaj parimi fonetik mund t'i hapë rrugë parimit morfologjik (çelës, çelësi, çelësin; dhjetësh, dhjetëshin etj.).

Duke pasqyruar këto zhvillime të gjuhës, këtë evolucion të anës së saj tingullore, mendojmë se kodifimi do të përputhet më mirë me normën e sotme të gjuhës, me praktikën e ligjërimit letrar dhe do të krijojë një bazë më të gjerë mbështetëse gjithkombëtare, gjë që do ta lehtësonte përvetësimin e gjuhës letrare dhe të drejtshkrimit të saj.

